



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 1256/2 Prot.

Tiranë, më 13 . 12 . 2023

V E N D I M

Nr. 248 , Datë 13 . 12 . 2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 243, datë 13.11.2023, e paraqitur nga Shoqata “Ilinden”, me përfaqësues z. N.Gj, kundër shtetasit Bullgar V.S, përfaqësues i Fondacionit Bullgar me seli në Bullgari, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “etnisë”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues pretendon se: “*Shtetasi Bullgar V.S, përfaqësues i Fondacionit Bullgar, me seli në Bullgari, kërcënon hapur pakicën kombëtare maqedonase në Republikën e Shqipërisë. Në kohën kur po zhvillohet regjistrimi i popullsisë, kudo ku ka popullsi maqedonase në të gjithë Republikën e Shqipërisë shkon dhe i bën presion, shkakton ankth të populli maqedonas në Republikën e Shqipërisë*”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit, të merret masa me gjorbë dhe të tërhiqet artikulli nga rrjeti social Facebook.

II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:

Shoqata “Ilinden”, është një organizatë jofitimprurëse, joqeveritare, e regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 2473, datë 06.09.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, shoqata ka si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së saj mbrojtjen e

interesave, të drejtave e identitetit etnik, kulturor dhe fetar të minoritetit kombëtar Maqedonas në Shqipëri.

Bazuar në ankesën e paraqitur, Shoqata “Ilinden” pretendon diskriminimin e pakicës kombëtare maqedonase në Shqipëri, nga ana e shtetasit Bullgar V.S, përmes presionit, kërcënimeve që i bën pakicës kombëtare maqedonase në Republikën e Shqipërisë në kohën kur po zhvillohet regjistrimi i popullsisë.

Bazuar në nenin 32, pika 1, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet: “1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektive...”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, por në mënyrë të shprehur neni 1, i ligjit parashikon mbrojtjen nga diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar, duke përcaktuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Neni 3, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 32/3, të LMD-së përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Plotësimi i kriterëve formale të një ankese, për të vijuar me shqyrtimin administrativ të saj, është hapi i parë, që ndiqet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në bazë të parashikimeve përkatëse ligjore. Ky detyrim i Komisionerit parashikohet në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

Mbështetur në parashikimin e nenit 44/2, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” organi publik shqyrton paraprakisht kërkesën e

depozituar nga pala, lidhur me përmbushjen e kriterëve formale ligjore, si kompetenca e organit publik, legjitimimi, afati, forma dhe çdo kriter tjetër të parashikuar nga ligji.

Në nenin 65, germa b), të ligjit të sipërpërmendur parashikohet gjithashtu se: *“Në fillim të procedurës administrative, organi publik kryen verifikimet e mëposhtme:...b) legjitimitetin e palës që ka paraqitur kërkesën për fillimin e procedurës administrative”*.

Neni 4 i LMD-së, përcakton se: *“1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare”*.

Neni 7 i LMD-së, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjerash personash, përbën diskriminim”*.

Për të vlerësuar legjitimitetin e palës kundër të cilit drejtohet ankesa, Komisioneri do i referohet parashikimeve të bëra në nenet 24, 26, 54 dhe 55 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë. Kështu, në këtë kod përcaktohet përmbajtja e personit juridik dhe fondacionet: *“24. Personat juridikë janë publikë dhe privatë. 26. Persona juridikë privatë janë shoqëritë, shoqatat, fondacionet dhe entet e tjera me karakter privat, të cilat e fitojnë personalitetin juridik në mënyrën e caktuar nga ligji. ... 54. Fondacioni është person juridik pa anëtarësi që ka për objekt arritjen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut. 55. Fondacionet krijohen nga persona fizikë ose juridikë me akt noterial ose me testament. Akti për krijimin e fondacionit, me kërkesë të themeluesve të tij, regjistrohet në gjykatë”*.

Referuar informacionit të dhënë nga ankuesi në formularin e ankesës dhe hulumtimeve të bëra online¹ nga inspektori i çështjes, rezulton se z. V.S është shtetas Bullgar dhe kryetar i Fondacionit Maqedonia me seli në Bullgari.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në përmbushje të qëllimit të ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin, shqyrton ankesat që drejtohen kundër autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë.

¹ <https://www.youtube.com/watch?app=>, min 21.25.

Duke qenë se z. V.S, është shtetas Bullgar dhe kryetar i një fondacioni me seli në Bullgari dhe nuk është subjekt i regjistruar në Republikën e Shqipërisë, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk ka kompetencë në shqyrtimin e ankesës në fjalë.

Për sa më sipër, bazuar në dispozitat e cituara më lart dhe parashikimeve të bëra në ligjin 10221/2021 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, rezulton se, z. V.S, është shtetas Bullgar dhe kryetar i një fondacioni me seli në Bullgari, nuk legjitimohet si subjekt kundër të cilit mund të paraqitet ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Gjithashtu, në provat² e pretenduara që janë vënë në dispozicion nga subjekti ankues, janë në gjuhë të huaj dhe linku ku pretendohet se janë publikuar artikujt hap faqen e profilit të shtetasit Bullgar, V.S dhe jo artikullin e pretenduar në formularin e ankesës.

Lidhur me këtë pretendim të ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është shprehur me Vendimin nr. 209, datë 23.10.2023.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se shtetasi Bullgar V.S “kërcënon hapur pakicën kombëtare maqedonase në Republikën e Shqipërisë”, Komisioneri vlerëson se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.³

Bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: ... b) është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji;”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, bazuar në nenin 33/4, germa “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri arrin në përfundimin se, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 33, pika 4, shkronja b), nenin 33, pika 10 të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

² <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=>
<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=>
<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=>
<https://www.facebook.com/photo.php?fbid=>

³ Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale....”

V E N D O S I:

1. Mospranimin e ankesës nr. 243, datë 13.11.2023, të paraqitur nga Shoqata “Ilinden”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA